

Kundërvënia fonologjike /r/-/R/, rrafshim dhe reflekse në gjuhën e folur dhe të shkruar

Dr. Haki HYSANAJ

4 qershor 2010

Përmbledhje

Në këtë punim bëhet fjalë për procesin e rrafshimit të kundërvënies fonologjike /r/-/R/ në shqipen e sotme standarde. Hulumtimi është shtrirë në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Korpusi për hulumtim ka përfshirë numër të konsiderueshëm çiftesh minimale. Për të mbërritur në rezultatet e supozuara paraprakisht janë anketuar nxënës dhe studentë të qyteteve të ndryshme të Kosovës. Përfundimet tregojnë se rrafshimi i kësaj kundërvënieje në shumicën e qyteteve të Kosovës është në fundin e tij. Analiza e përgjithshme ka qitur në pah faktin se rrafshimi është duke shkaktuar edhe lëkundje në sistemin e ndërlidhnive fonologjike të shqipes. Si pasojë hetohet "*lindja*" e një varianti të ndërmjetëm midis dy fonemave dridhëse të shqipes standarde.

Hulumtimi ndriçon edhe të dhënën se ky opozicion në zonat rurale ende ruhet për dallim nga ato urbane. Në këtë rrafshim pos faktorëve gjuhësorë kanë ndikuar edhe faktorë jashtëgjuhësorë.

Në këtë punim bëhet fjalë për procesin e rrafshimit të kundërvënies fonologjike /r/-/R/ në shqipen e sotme standarde. Hulumtimi është shtrirë në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Korpusi për hulumtim ka përfshirë numër të konsiderueshëm çiftesh minimale. Për të mbërritur në rezultatet e supozuara paraprakisht janë anketuar nxënës dhe studentë të qyteteve të ndryshme të Kosovës. Përfundimet tregojnë se rrafshimi i kësaj kundërvënieje në shumicën e qyteteve të Kosovës është në fundin e tij. Analiza e përgjithshme ka qitur në pah faktin se rrafshimi është duke shkaktuar edhe lëkundje në sistemin e ndërlidhnive fonologjike të shqipes. Si pasojë hetohet "*lindja*" e një varianti të ndërmjetëm midis dy fonemave dridhëse të shqipes standarde.

Hulumtimi ndriçon edhe të dhënën se ky opozicion në zonat rurale ende ruhet për dallim nga ato urbane. Në këtë rrafshim pos faktorëve gjuhësorë kanë ndikuar edhe faktorë jashtëgjuhësorë.

Kundërvënien fonologjike /r/-/R/ në shqipen e sotme standarde është duke kaluar fazën e fundit të procesit të rrafshimit fonologjik. Ky rrafshim ka prirje të ndikojë në lindjen e një varianti të ndërmjetëm tingullor midis r-së dhe rr-së, i cili, bazuar në gjendjen

e sotme, nyjëtohet si: /**r̄**/¹. Nyjëtimi i këtij varianti qëndron midis modeleve nyjëtimore të **r**-së dhe **rr**-së të shqipes standarde. Kjo prirje, mbështetur në hulumtimin tonë, ka prekur sistemin fonematik të shqipes, pra inventarin e fonemave të saj, ndërsa rrafshimi duket se është duke ndryshuar edhe radhët e ndërlidhnive korrelative të fonemave bashkëtingëllore, duke lënë sistemin të zbrazët për një kundërvënie.

Rrafshimi i opozicionit /**r**/ dhe /**R**/, si dhe shfaqja e një **r**-je të ndërmjetme, së paku në variantin e folur, ka gjetur shtrirje edhe në standardin e shqipes, ndërsa në ligjërimin e shkruar çështja del shpesh më e ngatërruar. Sipas kësaj, procesi në përfundim është më i kapshëm në ligjërimin e folur se në të shkruarin, në të cilin takohen lëkundje të shumta drejtshkrimore. Kjo gjendje reflektohet në ese nxënësish e studentësh, në gjuhën e shkruar të administratës, në emërtime, në gjuhën e reklamave.

Në këtë situatë konsideroj se pos përshtimit të gjendjes në të cilën përdoret ky opozicion dhe i fonemave /**r**/ e /**R**/ në fjalë të ndryshme jashtë sistemit të ndërlidhnisë, duhen identifikuar edhe faktorët themelorë që kanë çuar më tej këtë proces fonetiko-fonologjik.

Siç do të shihet më poshtë procesin e kanë shtyrë përpara faktorë të ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Si rrjedhojë fonemat /**r**/ dhe /**R**/ gjithnjë e më shpesh dalin edhe me reflekse të ndryshme, që hë për hë mund të konsiderohen si alofone, pasi që nuk krijojnë opozicione fonologjike. Ndërsa, në variantin e shkruar të shqipes standarde, reflekset e tyre, që identifikohen po me të njëjtat grafema, shënojnë lëkundje drejtshkrimi, që duket shumë i ndikuar nga variateti i gjuhës së folur.

Ky realitet i ri fonetiko-fonologjik, i reflektuar edhe në gjuhën standarde, më shumë lidhet me prirjen e vibrantes /**R**/ për të kaluar drejt /**r**/-së, por edhe të shfaqjes dhe të përdorimit gjithnjë e më shumë të variantit tashmë të identifikuar si **r̄**, që nuk është tjetër veçse e kundërta e prirjes së parë. Në këtë situatë nuk do mend se vështirësohet kuptimi. Në trajtën e folur ngatërrimet zënë të shturen vetëm në kuadër të kontestit gjuhësor. E njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën e shkruar, në rastet kur kemi rrafshim, ose edhe në rastet kur ndikimi i trajtës së folur ka bërë që dridhësja /**R**/ të anojë drejt /**r**/-së, pra kur **r**-ja zëvendëson **rr**-në dhe e kundërta. Në të dy rastet nuk kemi të bëjmë me variante pozicionale, kombinatorë e as stilistike.

Pohimet e mëparshme për rrafshim dhe reflekse të këtyre fonemave bazohen në hulumtimin e përdorimit të tyre në ligjërimin e shkruar e të folur të nxënësve dhe studentëve, si dhe folësve eminentë të shqipes standarde. Rezultatet e një ankete gjuhësore, realizuar më nxënës të shkollave të mesme dhe me studentë të Universitetit të Prishtinës, kanë vërtetuar lëkundjet e sistemit të ndërlidhnive, posaçërisht kur bëhet fjalë për fonemat /**r**/ dhe /**R**/. Pos kësaj hulumtimi ka mundur edhe identifikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë, që kanë ndikuar në këtë rrafshim, si dhe në lindjen e varianteve të përafërta tingullore me këto dy fonema.

Deri tash faktorët ekstralingistikë, të paktën për këtë kundërvënie, nuk kanë qenë pjesë e hulumtimeve shkencore.

Përgjigjet e të anketuarve që jetojnë në zona urbane dëshmojnë se procesi i rrafshimit ka përfunduar në shumicën e qyteteve të Kosovës, njëjtë siç ka ndodhur edhe në shumicën e qyteteve ku flitet toskërishtja, ndërsa përgjigjet e të anketuarve që janë nga zonat

¹Me /**r**/ identifikohet varianti i ndërmjetëm tingullor, që qëndron midis **r**-së dhe **rr**-së.

rurale kanë dëshmuar ende karakterin funksional të saj. Rezultatet e ndryshme e të anketuarve, gjuha e të cilëve identifikon ata me vendbanimin e tyre, e bën të rëndësishëm për hulumtim këtë faktor.

Studimet e deritashme rreth këtij procesi, i nisur shumë vite më parë në të folme të ndryshme të shqipes, fillimisht në të folmet toske, kanë vënë në pah vetëm faktorët gjuhësorë, siç është ngarkesa jo e madhe funksionale e kundërvënies² dhe jostabiliteti i saj për shkak të përjashtimit fonologjik që paraqet në sistemin bashkëtingëllor të shqipes, pasi që ngrihet mbi bazë të kuantitetit, tipar që është treguar edhe joekonomik në shqipë³.

Siç dihet fonemat /r/ -/R/ janë pjesë e sistemit fonetiko- fonologjik të shqipes standarde, të kodifikuara në normë. Ato hynë në raporte kundërvënese, duke shfrytëzuar tipare të ndryshme nyjëtimore dhe akustike.

/r/ dhe /R/ formojnë opozicion fonologjik mbi bazë të gjatësisë, të intenzitetit dhe të numrit të dridhjeve. Kundërvënia është më tepër e karakterit sasiar. "*Dallimi midis tyre konsiston në sasinë e dridhjeve, që në fakt është një kompleks fonetik: bashkë me numrin e dridhjeve kemi intenzitetin, sasinë e sonoritetit, etj.*"⁴.

Matjet akustike të tipareve të këtyre fonemave, në pozita të izoluar, kanë treguar se raportet e gjatësisë, që lidhen edhe me numrin e dridhjeve, janë: 11 qs për r-në, ndërsa për rr-në 20 qs, kurse vlerat e formanteve tregojnë se F1 për /r/ është 316 Hz, ndërsa për /R/ 300 Hz dhe F2 për /R/ shtrihet në frekuencat 1114 Hz, ndërsa F2 në 1100 Hz⁵. Sipas këtyre parametrave /r/-ja del më e përparme, më e hapur, më e shkurtër, më pak intensive dhe më pak sonore se /R/-ja⁶.

Vendi i formimit nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në këtë kundërvënie. Prandaj, sot ka aq shumë mundësi për një fushë më të gjerë dispersioni të /R/-së, e cila në të njëjtën kohë krijoi edhe mundësi për reflekse dhe variante të mundshme në kuadër të sistemit fonetik të shqipes, gjë që po provojmë ta dëshmojmë.

Një vit pas **Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) Rexhep Ismajli** konstaton se në të folmet e qyteteve si Peja, Dibra dhe një numër vendbanimesh urbane të jugut, e kanë zhdukur fare dallimin. "*Në gjuhën standarde dallimi sasiar ekziston dhe bën pjesë në kodin e normës drejtshqiptimore, ashtu siç na del edhe në shumicën e të folmeve të tjera, sidomos në veri*"⁷, shprehet **Ismajli**.

Por, realiteti i ri sot tregon se procesi i rrafshimit opozicional midis këtyre dy fonemave ka gjetur shtrirje edhe në të folmet veriore, duke mos kursyer edhe standardin. Në këtë rast dialekti duket se ka ndikuar mbi standardin, dukuri kjo jo shumë e shprehur as në gjuhët e tjera.

Hulumtimi ynë tregon se rrafshimi /r/ -/R/ është prezent në të gjitha qytetet e Kosovës, ndërkohë që funksionaliteti i kësaj kundërvënieje takohet vetëm në të folme zonash rurale. Por, edhe këtu janë evidentuar lëkundje në dallimin e /r/-së nga /rr/-ja,

²Shih: **A. Dodi**, *vep. cit.* f. 100.

³Shih: **R. Ismajli**, *vep. cit.* f. 190

⁴**Rexhep Ismajli**, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë, 1985, f. 190.

⁵**Haki Hysenaj**, *Tiparet akustike dhe distribucionale të tingujve të gjuhës së sotme shqipe*(punim magjistrature), Prishtinë, 1992, f. 100.

⁶**H. Hysenaj**, *punimi i cituar*, f. 100.

⁷**Rexhep Ismajli**, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 215.

dhe anasjelltas.

Për të vërtetuar pohimet për gjendjen sot të këtyre dy fonemave në shqipen e folur dhe për të parë edhe gabimet që bëhen në trajtën e shkruar të standardit ne kemi provuar që me ndihmën e një ankete gjuhësore të mbërrijmë në përfundime konkrete. Nga ana tjetër edhe gjuha e mediave elektronike ka qenë pjesë e hulumtimit tonë.

Anketa është plotësuar nga 85 maturantë të gjimnazit "*Bedri Pejani*" të Pejës, 74 prej të cilëve janë të lindur dhe jetojnë në qytet, ndërsa 14 të tjerë në fshatra të ndryshme. E njëjta anketë është plotësuar edhe nga 80 studentë të Fakultetit të Filologjisë. Të anketuarit kanë përfaqësuar shumicën e qyteteve të Kosovës.

Anketa është përbërë nga 25 fjali. Çdo njëra ka përmbajtur së paku një fjalë që ka filluar me njërën nga fonemat dridhëse. Të anketuarit kanë pasur për detyrë të plotësojnë hapësirat e zbrazëta për shkronjat **r** dhe **rr**. Në mesin e këtyre fjalive kanë qenë edhe çiftet minimale: **ara/arra, rasa/rrasa dhe ruaj/rruaj**.

Rezultatet e anketës: (nxënës nga qyteti)

Kundërvënia /r/ - /R/ në çiftet minimale: **ruaj-rruaj; ara-arra dhe rasa-rrasa** nuk njihet nga 54 nxënës, ose shprehur në përqindje 76%, ndërsa 17 prej tyre, ose 24% bëjnë dallim të pjesshëm.

Përgjigjet e nxënësve nga fshatrat:

Të gjithë të anketuarit nga fshatrat, d. m. th. 14 sish, njohin në plotëni këtë kundërvënie në çiftet minimale të zgjedhura, por bëjnë edhe gabime gjatë përdorimit të dridhëseve /r/ dhe /R/ në fjalë të ndryshme.

Rezultat janë gati të ngjashme edhe për fjalët që nisin me /R/. 59 nxënës nga qyteti, ose 83%, në vend të fonemës /R/ të fjalëve: **rrahu, rrallëherë, rraskapitur, i derrave, terri, rrugë, rrebesh, rrethi, rrezet, rrëmuje, rruga, rreptësi, rrathë dhe rrush** përdorin fonemën /r/, ndërsa 12 prej tyre, ose 17% i shkruajnë drejt këto fjalë.

Nga nxënësit me origjinë nga fshati vetëm 4 prej tyre ngatërrojnë pjesërisht përdorimin e këtyre dy fonemave. Edhe te këta nxënës vërehet tendenca e përdorimit të fonemës /r/ në vend të /R/-së. Gjithnjë kemi të bëjmë me rezultate nga hulumtimi i variantit të shkruar të gjuhës standarde.

Bazuar në përgjigjet e këtyre informatorëve mund të konkludohet se rrafshimi i këtij opozicioni fonologjik në trajtën e folur, por edhe në trajtën e shkruar, në qytetin e Pejës është në fazën e fundit.

Se kjo gjendje ka përfshirë edhe gjuhën e administratës dëshmojnë edhe emërtimet: "*Karagaç*" në vend të "**Karragaç**", "*Mbreti Piro*" (emër rruge), në vend të trajtës së drejtë "**Mbreti Pirro**".

Siç shihet procesi i rrafshimit të opozicionit /r/ - /R/ në qytetin e Pejës, në trajtën e shkruar, ka përfunduar. Ndërsa në trajtën e folur /r/-ja nuk është dridhësja e kodifikuar e shqipes, porse varianti i përmendur në fillim të kësaj kumtese, i cili thamë se nyjëtohet si tingull i ndërmjetëm midis /r/-së dhe /R/-së, pra si /r̄/. Kështu, në këtë qytet sot të gjitha fjalët që fillojnë me /R/ nyjëtohen me këtë variant tingullor. P. sh ruga, rëna,

řethi, řoga, etj.

Edhe rezultatet e anketës së realizuar me studentë të Fakultetit të Filologjisë gati të përafërta me rezultatet e mësipërme. Të njëjtën anketë e kanë plotësuar 80 studentë të qyteteve të ndryshme të Kosovës. P. sh. nga 23 të anketuar, studentë të lindur në Prishtinë, 11 prej tyre, ose 49% nuk njohin opozicionin fonologjik /r/ -/ R/, ndërsa fjalët që fillojnë me /rr/ 61% prej tyre i shkruajnë me /r/. 57 studentët e tjerë, që janë nga qendrat kryesore të vendit, kanë bërë të njëjtat gabime. Përqindjet janë të përafërta.

Nga përvoja gjatë e punës me studentë kemi hetuar se shumë prej tyre në trajtën e folur fjalët që fillojnë me /R/ i shqiptojnë me variantin e përmendur më parë. Gjithnjë edhe këtu kemi të bëjmë me prirjen për një tingull të ri që lidhet me ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë.

Së fundi duhet përmendur se rrafshimi i këtij opozicioni dhe prirja për një variant të ri, që në perspektivë mund të kryejë rolin e një foneme të caktuar në sistemin fonetiko-fonologjik të shqipes, ka prekur edhe gjuhën e folësve eminentë të standardit. Të kujtojmë reklamën e përsëritur më shumë se një vit në televizionet kombëtare: "Bíra Peja është më e míra", dhe të kundërtën, kur në vend të vibrantes /r/ spikerë dhe moderatorë televizionesh dhe radiosh nyjëtojnë /ř/, si në shembujt: R(ř)adio Televizioni i Kosovës (RTK), r (ř)espekt (respekt-i), r(ř)oman (roman-i), etj.

Për fund do të thosha se shkaqet e këtij rrafshimi, i nisur shumë decenie më parë në zonat urbane të të folmeve toske, tashti është në fazën e fundit edhe në të folmet e zonave urbane gege. Ky rrafshim po përcillet edhe me refleksë të ndryshme në trajtën e folur, ndërsa në trajtën e shkruar me gabime të shumta ortografike. Shkaqet duhen kërkuar në 3 drejtime:

1. Së pari është rendimenti jo i madh funksional i kundërvënies faktor gjuhësor, i cili ka ndikuar në këtë lëkundje sitemi. "*Dridhësja rr përdoret në një numër më të kufizuar fjalësh se r-ja*"⁸. Si pasojë edhe denduria e përdorimit është në anën e fonemës /r/. Në tregimin "*Fyelli magjik ose kambanat e humbura*", që shtrihet në 6 faqe tekst, të shkrimtarit **Beqir Musliu**, fonema /r/ përdoret 314 herë, ndërsa fonema /R/ vetëm 29 herë.
2. Faktor i dytë është ndikimi i sistemeve fonetiko-fonologjike të gjuhëve që janë në kontakt me shqipen. Greqishtja, italishtja dhe gjuhët sllave, gjuhë në kontakt me shqipen, njohin vetëm një fonemë dridhëse, prandaj duke qenë me prestigj përballë shqipes kanë ndikuar në rrafshimin e kësaj kundërvënieje dhe në vetë mënyrën e nyjëtimimit të dridhësëve r dhe rr.
3. Dhe së fundi të dhënat dialektore, si dhe studimet e bëra për sistemet fonetiko-fonologjike të të folmeve të ndryshme të shqipes, dëshmojnë për rrafshim të kësaj kundërvënieje fonologjike së pari në zonat urbane.

Rezultatet e hulumtimit tonë, duke ndarë informatorët sipas vendit të lindjes dhe vendbanimit, përforcojnë konstatimet e deritashme. Prandaj, konsideroj se krahas dy faktorëve të parë, që mund të konsiderohen esencial në këtë rrafshim, faktori jashtëgjuhësor nuk duhet lënë anash. Këtu kemi të bëjmë me ndjenjën e banorëve urbanë për diferencim gjuhësor nga banorët ruralë, pos në sisteme të tjera të gjuhës edhe në sistemin fonetiko-

⁸ A. Dodi, *vep. cit.* f. 100.

fonologjik.

Në këtë situatë, kur mungojnë modelet nyjëtimore për këto dy fonema, kujtoj se orvatjet për ndonjë ortofoni do të rezultonin pa sukses. Prandaj, më duket se këto dy fonema janë duke ndikuar në riformimin e sistemit dhe gradualisht edhe në krijimin e ekuilibreve të reja fonologjike në standardin në evoluim të shqipes.

Referencat:

1. **Dodi, Anastas.** (2004) *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 100.
2. **Ismajli, Rexhep.** (1985) *Gjuha shqipe e kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë, f. 190.
3. **Ismajli, Rexhep.** *Vep. cit.* f. 190.
4. **Hysenaj, Haki.** (1992) *Tiparet akustike dhe distribucionale te tingujve të gjuhës së sotme shqipe* (Punim i magjistraturës), f. 100.
5. **Hysenaj, Haki.** *Pun. i cit.* f. 100.
6. **Ismajli, Rexhep.** (1987) *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, f. 215.
7. **Dodi, Anastas.** *Vep. cit.* f. 108.
8. **Musliu, Beqir.** (2002) *Kori i gjelave të vdekur*, Pejë, f. 101-107.